



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 7.7.2020

### R A P O R T

#### **PËR DEKRETIN NR.11 510, DATË 15.6.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “ PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 62/2020 “PËR TREGJET E KAPITALIT”**

#### **I. HYRJE.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 7 korrik 2020, shqyrtoi dekretin nr.11510, datë 15.6.2020, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Dekreti u shqyrtua në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 32-38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni caktoi relator, për këtë dekret, z. Ervin Bushati.

Mbështetur në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, dekreti u shqyrtua vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës. Shqyrtimi i dekretit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe dorëzimi i raportit të këtij Komisioni u bënë brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend (dekreti është depozituar në Kuvend në datën 16 qershor 2020 dhe afati për dorëzimin e raportit të komisionit është brenda datës 14 korrik 2020).

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të dhënë mendime mbi dekretin dhe informacione të kërkuara nga deputetët:

Nga Presidenca:

- Z. Bledar Dervishaj, Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore;
- Znj. Katrin Treska, Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Institucionin e Presidentit të Republikës.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre;
- Z. Saimir Muçmataj, Drejtor Juridik.

Nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:

- Znj. Violanda Theodhori, Drejtoreshë e Departamentit të Çështjeve Ligjore;
- Z. Niko Kotonika, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Kapitaleve.

Për të pasur një mendim sa më profesional për çështjet e parashtruara në dekret, Komisioni mori mendimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si institucione që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me Komisionin për Ekonominë dhe Financat gjatë shqyrtimit të tij në Kuvend.

## **II. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### **Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:**

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.
2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.
3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.
9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

### **III. ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.**

Dekreti nr.11510, datë 15.6.2020, i Presidentit të Republikës, shoqërohet me arsyetimin për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Në këtë arsyetim theksohet se ligji për tregjet e kapitalit përmban disa problematika, që janë:

*Së pari*, ligji përmban disa problematika të përputhshmërisë me parimet kryesore kushtetuese të:

- sigurisë juridike;
- lirisë së veprimtarisë ekonomike;
- barazisë para ligjit;
- respektimit të shumicës së cilësuar për miratimin e ligjeve, të parashikuar në nenin 81 pika 2 të Kushtetutës;
- hierarkisë së akteve, të përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës;
- delegimeve për rregullimin e çështjeve me akte nënligjore, të përcaktuar në nenin 118 pika 2 të Kushtetutës.

Gjithashtu, sipas arsyetimit të dekretit, ligji përmban problematika të qartësisë së normës juridike dhe krijon vështirësi në zbatimin e dispozitës në mënyrë të njëjtë e, për pasojë, të barabartë.

*Së dyti*, ligji për tregjet e kapitalit ka disa mospërputhje me kuadrin rregullator dhe financiar të vendit tonë.

*Së treti*, disa dispozita të ligjit për tregjet e kapitalit, që trajtojnë licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve në këtë fushë, janë me problematika.

Në arsyetimin e dekretit për kthimin e nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, Presidenti i Republikës ka parashtruar disa argumente ku bazon përfundimin e tij, të cilat janë si më poshtë:

**Argumenti 1:** Aktualisht, në vendin tonë nuk janë përmbushur parakushtet për një zhvillim të suksesshëm të tregjeve të kapitalit.

*1. Problematika kryesore e këtij akti qëndron në faktin se, aktualisht, nuk janë përmbushur parakushtet për një zhvillim të suksesshëm të tregjeve të kapitalit.*

*1.1. Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e tij të nëntorit 2017, tërheq vëmendjen se zhvillimi i tregut të kapitalit duhet të udhëhiqet nga standardet e BE-së, por gjithashtu thekson se zhvillimi i tij do të marrë kohë dhe është një proces i ndërlikuar. Zhvillimi i tregjeve të kapitalit do të kërkojë zbatimin e standardeve më të larta në lidhje me transparencën, qeverisjen e korporatave dhe mbikëqyrjen. Gjithashtu, duhet të adresojë reformat si zvogëlimi i informalitetit dhe nxitjen e kursimeve kombëtare.*

*1.2 Nga pikëpamja financiare, parakushtet për një zhvillim të suksesshëm të tregut të kapitalit privat, janë:*

- *Politika e shëndoshë makroekonomike: Politika monetare racionale dhe politika të qarta të administrimit të borxhit për të siguruar lëvizjet e parashikueshme të normës së interesit;*
- *Një kornizë e përshtatshme ligjore për të mbrojtur investitorët, një strukturë solide rregullatore dhe mbikëqyrëse për letrat me vlerë, miratimi i standardeve më të larta për cilësinë e informacionit dhe zbulimin publik, kontabiliteti i besueshëm, proceset e auditimit dhe qeverisja e shëndoshë e korporatave, si elementë të nevojshëm për të ndërtuar besimin;*
- *Duhet të ekzistojnë ekonomi të shkallës që nevojiten për të zhvilluar një treg privat të kapitalit që ka nevojë për likuiditet dhe kërkon një vëllim të konsiderueshëm të investitorëve;*
- *Investitorët vendas luajnë një rol kryesor për zhvillimin, dhe ekzistenca e fondeve të mëdha pensionale dhe fondeve të investimeve shoqërohet me tregjet e suksesshme të kapitalit privat.*

*1.3 Përvoja e vendeve anëtare të BE-së tregon se reformat institucionale dhe ato të tregut ishin faktorët kryesorë që nxitën zhvillimin e tregjeve të kapitalit në vitet 2000. Reformat kryesore përfshijnë privatizimet që kërkonin listim të detyrueshëm të kompanive, reformat e fondeve të pensioneve dhe hyrjet e kapitalit të nxitur nga anëtarësimet në BE, pasi vendet harmonizuan shpejt kornizat ligjore dhe rregullatore. Por zbatimi në praktikë ishte i dobët për shkak të:*

- *Mungesës së qeverisjes së fortë të korporatave, që minoi zhvillimin financiar duke kërkuar standarde më relaksuese të listimit të korporatave;*
- *Likuiditeti i kufizuar ka qenë një pengesë e rëndësishme për investitorët dhe zhvillimin e tregut;*
- *Standarde të papërshtatshme të raportimit, mungesë e vlerësimeve të rating-ut të besueshëm të korporatave dhe strukturave të pronësisë.*

*1.4 Për t'u kthyer në situatën aktuale të vendit tonë, vlen të theksojmë se:*

*Disa nga korporatat kryesore në Shqipëri kanë emetuar tashmë bono, dhe listimi i bonove në këmbim mund të jetë një hap më i natyrshëm për ta. Por mbi të gjitha, problematikë mbeten disa tregues që kërkojnë paraprakisht adresim:*

- *Një nivel i lartë i borxhit publik si dhe ndërmarrja vazhdimisht e iniciativave të reja ligjore të cilat rrezikojnë rritjen e nivelit të këtij borxhi;*
- *Një pjesë e mirë e PBB-së (e vlerësuar rreth 50%), akoma përbëhet nga ekonomia informale, e cila pengon programin e reformave ekonomike që janë në zhvillim e sipër (raporti i Bankës Botërore nr. 17, Pranverë 2020, vlerëson në nivelin 61% informalitetin në punësim në përqindje të forcave të punës);*

- *Madhësia e vogël e ndërmarrjeve me sisteme të dobëta të qeverisjes korporative;*
- *Mungesa e një listë të qartë të kompanive që veprojnë në vend, të sistemeve të dobëta të kontrollit të bilanceve të çertifikuara të kompanive dhe shifrave reale të hapura për publikun, kërkesë kjo thelbësore që të gëzohet më pas besueshmëria e bursës;*
- *Institucione të dobëta qeverisëse legale, rregullatore dhe korporative për të mbrojtur investitorët (në raportin Doing Business 2020, Shqipëria renditet në vendin e 111 nga 190 vende në lidhje me mbrojtjen e investitorëve);*
- *Kreditë e këqija mbeten në një nivel të lartë në krahasim me vendet e rajonit. Me gjithë përpjekjet e konsiderueshme të Bankës së Shqipërisë për të pastruar bilancet e bankave, xhepat e cenueshmërisë mbesin dhe nevojitet zvogëlim i mëtejshëm i nivelit të kredive të këqija;*
- *Mungesa e një vlerësimi të korporatave shqiptare nga kompani të vlerësuara ndërkombëtarisht.*

*Ndaj, është momenti që të reflektohet mbi faktin se, zhvillimi i një tregu të kapitaleve kërkon patjetër plotësimin e parakushteve ku në mënyrë të veçantë, adresimin e standardeve të dobëta të qeverisjes së korporatave. Nëse nuk merren masa rregullatore për të adresuar këto problematika, me miratimin e këtij ligji dhe nisjen nga zbatimi të tij, Shqipëria do të përballlet me riskun që bursa të jetë spekulative dhe si rrjedhim, jo funksionale. Kjo do të krijonte premisën e rritjes së nivelit të pasigurisë së produkteve financiare apo dhe vetë stabilitetin ekonomiko-financiar të vendit.*

**Argumenti 2:** *Ligji i jep AMF-së të drejta të pakufizuara në fushën e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të veprimtarive që janë objekt i tij, duke rrezikuar të cenohet parimin e sigurisë juridike, lirinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike nga subjektet e licencuara dhe barazinë para ligjit.*

*Ligji nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, ka përcaktuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare si autoritet, i cili licencon, mbikëqyr dhe rregullon veprimtaritë e rregulluara sipas këtij ligji. Fusha e veprimtarisë së Autoritetit, në funksion të përmbushjes së objektivave të ligjit, është e përcaktuar në nenin 7, ndërsa në nenin 8 renditen kompetencat e tij në lidhje me zbatimin e ligjit. Disa prej kompetencave të renditura, i njohin këtij autoriteti të drejta të pakufizuara, ç’ka rrezikon të cenohet në praktikë parimin e sigurisë juridike, duke shkaktuar pasiguri të theksuar në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike nga subjektet e licencuara.*

*2.1 Për ilustrim, shkronjat “a)”, “b)” dhe “g)”, i njohin Autoritetit kompetencat për:*

*“a) i jep udhëzime ose urdhra të përgjithshme ose të veçanta çdo personi që ushtron veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji;*

*b) u kërkon vlerësuesve, audituesve ose ofruesve të shërbimeve ndihmëse për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari të rregulluara sipas këtij ligji, dhënien e çdo informacioni që Autoriteti mund ta konsiderojë të rëndësishëm për kryerjen e funksioneve të tij;*

*g) pezullon listimin e çdo instrumenti financiar, përjashton nga listimi instrumentet financiare të listuara ose ndalon tregtimin e çdo instrumenti financiar, ose merr hapat që i çmon të nevojshëm ose të përshtatshëm për të siguruar mbrojtjen e investitorëve ose për të siguruar një treg të drejtë dhe të rregullt të titujve, ose për të siguruar integritetin e tregut të titujve;”.*

*Parashikime të tilla, pa asnjë përcaktim të mënyrës se në cilat raste ushtrohen këto kompetenca; se kur jepen udhëzime apo urdhra të detyrueshme për t`u zbatuar; kur mund të kërkohet pezullimi i listimeve të instrumenteve financiare; apo për cilat raste mund t`u kërkohet informacion dhe i çfarë lloji subjekteve, janë parashikime të paqarta që lënë hapësira për zbatim të diferencuar e për pasojë, aplikime me standarde jo të unifikuara.*

## *2.2 Të njëjtën problematikë paraqesin edhe këto dispozita:*

*- Neni 18 i ligjit, në pikën 1, shkronja “b”, parashikon se: “Kur miraton një licencë ose regjistrim, Autoriteti mund:*

*b) të vendosë kushte ose kufizime që i mendon të përshtatshme Autoriteti.”*

*Po në këtë nen, në pikën 3, parashikon: “Çdo person juridik ose person i regjistruar, i cili shkel ndonjë prej kushteve ose të kufizimeve të vendosura në një licencë ose regjistrim, mund të jetë objekt i ndërhyrjes që e mendon të përshtatshme Autoriteti sipas kompetencave të tij, në zbatim të nenit 30 të këtij ligji.”.*

*- Neni 21, pika 4, shkronja “a)”, që parashikon se: “Autoriteti mund: a) të miratojë kërkesën e paraqitur për ndryshimin e licencës ose regjistrimit, me kushtet ose kufizimet që i gjykon të përshtatshme;”.*

*- Neni 45, pika 4, që parashikon se: “Miratimi i Autoritetit mund të jepet pa kushte ose mund të jetë objekt i kushteve apo i kufizimeve që i gjykon të përshtatshme Autoriteti.”*

*- Neni 121, pika 5, që parashikon se: “Autoriteti mund të miratojë transferimin e pjesëmarrjes influencuese pa kushte ose me kushtet ose kufizimet që i gjykon të përshtatshme Autoriteti.”*

- Neni 195, pika 4, që parashikon se: “Autoriteti mund të miratojë kërkesën për licencë për të operuar shtëpinë e klerimit, duke vendosur kushtet që i çmon të arsyeshme, me kusht që subjekti kërkues të ketë depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.”

Edhe pse në pamje të parë duket sikur këto hapësira i lihen diskrecionit të Autoritetit për të ushtruar mbikëqyrje efektive mbi veprimtarinë në këtë fushë, në fakt, këto hapësira të parregulluara veprimi pa përcaktuar kufizimet apo kushtet që mund t'i vendosen një subjekti privat, si dhe mungesa e qartësisë mbi llojin e masave që merren në proporcion me shkeljet e kryera, lënë vend për abuzime gjatë zbatimit në praktikë dhe për cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, përmes masave jo proporcionale dhe ligjore që mund të rëndojnë mbi subjektet.

2.3. Po për shkak të mospërcaktimit në mënyrë të qartë të rasteve kur refuzohet licenca, edhe dispozitat e nenit 20 dhe 24 të ligjit duhen riparë për të përcaktuar në cilat raste Autoriteti ka të drejtë të refuzojë kërkesën për licencim të shoqërisë komisionere apo përkatësisht të personit fizik ose të agjentit të lidhur.

Veçanërisht mënyra e formulimit të shkronjës “c)” të nenit 20 dhe të shkronjës “b)”, të nenit 24, me të tre nën paragrafët që përmbajnë, kur miratimi i kërkesës kushtëzohet me aftësinë për të ushtruar funksionin mbikëqyrës nga ana e vetë autoritetit dhe jo me kushte apo kritere që duhet të përmbushen nga subjekti, përbën një rregullim që sërish çon në vështirësi të zbatimit të dispozitës në mënyrë të njëjtë e për pasojë të barabartë.

2.4. Autorizim i pakufizuar nga legjislatori, madje në kundërshtim me hierarkinë e akteve të përcaktuara në nenin 116 të Kushtetutës, i është dhënë Autoritetit edhe nga neni 147, pikat 3 dhe 6, ku lidhur me kriteret që merren në shqyrtim për dhënien e licencës së veprimtarisë së bursës, këto dy paragrafë parashikojnë se:

“3. Autoriteti mund vendosë të japë licencën si bursë duke vendosur kushtet që i çmon të arsyeshme, me kusht që të jenë depozituar të gjitha informacionet e kërkuara.

6. Pa cenuar karakterin e përgjithshëm të kushteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, Autoriteti mund të ndryshojë, të revokojë ose të vendosë kushte dhe afate të reja nëse çmon se ato janë të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve ose për rregullimin e duhur të tregut.”;

Ndërsa lidhur me refuzimin e licencës, neni 148, shkronja “b)”, përcakton se Autoriteti refuzon dhënien e licencës edhe kur “nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e këtij ligji”.

2.5. E njëjta hapësirë është lënë për Autoritetin edhe në nenin 195, pikat 7 dhe 196, shkronja “a)”, sa i takon kërkesës për licencim për të krijuar dhe/ose për të operuar një shtëpi klerimi.

2.6. Parashikim i njëjtë është dhe në nenin 224, pika 4 dhe 8, si dhe në nenin 225, shkronja “a)”, sa i takon kërkesës për licencim për të themeluar dhe/ose për të operuar një regjistrar ose një depozitar qendror.

2.7. Edhe sa i takon kërkesës për licencë si Agjenci e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, sërish mes rasteve të refuzimit të saj nga Autoriteti, shkronja “c)” e nenit 236, parashikon se: “Autoriteti refuzon licencën për Agjenci të Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit: b) nëse nuk bindet se shoqëria do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet sipas këtij ligji;”

Kushtet dhe kriteret për dhënien apo heqjen e një licence, si dhe për refuzimin e kërkesës për licencë, nuk mund të lihen në vlerësimin subjektiv dhe të ndryshueshëm kohë pas kohe të Autoritetit. Ato duhet të jenë të përcaktuara qartë në ligj dhe asnjë autoritet tjetër nuk mund t'i ndryshojë ose revokojë me një akt tjetër. Këto dispozita cenojnë nenet 11 dhe 18 të Kushtetutës, lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe barazinë përpara ligjit dhe për pasojë, duhet të rishihen.

**Argumenti 3:** Në shumë dispozita të ligjit nuk është bërë delegim i mirëfilltë për rregullimin e çështjeve të caktuara sipas kërkesave të nenit 118 të Kushtetutës, por është lënë në mënyrë opsionale mundësia e Autoritetit për të rregulluar me akt nënligjor çështje të caktuara.

Delegime të paqarta për rregullimin e çështjeve me akte nënligjore, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 118 të Kushtetutës përmbajnë:

- Neni 7, pika 2, ku thuhet se:

“Në zbatim të sa më sipër, Autoriteti mund të miratojë rregullore për:

a) nxitjen e standardeve të larta të integritetit dhe të tregtimit të ndershëm gjatë ushtrimit të veprimtarive të rregulluara me këtë ligj;

b) sigurimin e transparencës në dhënien e informacioneve për interesat dhe faktet me rëndësi materiale në transaksionet e kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së rregulluar, përfshirë informacionet për komisione e stimuj të tjerë të arkëtuar ose të arkëtueshëm nga palë të treta në lidhje me këto transaksione;

c) mbrojtjen e parave dhe të aktiveve të klientëve;

ç) mbajtjen e llogarive dhe të regjistrave të duhur nga personi i licencuar, i regjistruar ose i njohur sipas këtij ligji, në formën që mund të përcaktohet nga Autoriteti dhe që garanton kontrollin e tyre nga Autoriteti;

- Neni 12, pika 3, ku thuhet se:

“3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore rrethanat në të cilat personi konsiderohet se vepron në kuadër të veprimtarisë së tij tregtare, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.”.



- Neni 14, pika 4, ku thuhet se:

*“4. Autoriteti mund t’i kërkojë subjektit kërkuar që personi juridik ose individët, sipas pikës 2 të këtij neni, t’i japin Autoritetit informacione të mëtejshme në lidhje me kërkesën për licencë, sipas formës dhe mënyrës që mund të përcaktojë Autoriteti.”.*

- Neni 22, pika 4, ku thuhet se:

*“4. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore procedurën e kërkesës për regjistrim, përmbajtjen e kërkesës për regjistrim të agjentit të lidhur, si edhe dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën.”*

- Neni 27, pika 3, ku thuhet se:

*“3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore procedurën që ndiqet për të kërkuar njohjen e licencës së personit të huaj.”.*

- Neni 42, pika 2, ku thuhet se:

*“2. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore standardet e sjelljes së personave të certifikuar.”.*

- Neni 50, pikat 1 dhe 2, që përcaktojnë se:

*“1. Autoriteti mund të miratojë rregullore në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive komisionere të licencuara, të njohura dhe të regjistruara, të cilat Autoriteti i konsideron të nevojshme për të mbrojtur interesat e klientit, për të siguruar funksionimin e drejtë e të rregullt të tregjeve financiare, për të parandaluar rrezikun sistematik në sistemin financiar dhe për të rritur standardet profesionale të shoqërive komisionere e të personave të regjistruar dhe të njohur.*

*2. Ndër të tjera këto rregullore mund:*

*“a) të kërkojnë nga shoqëritë komisionere, të cilat përdorin agjentë të lidhur, të vendosin kufizime për veprimtarinë e ushtruar prej agjentëve;”.*

- Neni 55, pikat 3 dhe 4, që përcaktojnë se:

*“3. Autoriteti mund të parashikojë zbatimin e një formule të bazuar në kapitalin themeltar ose në kërkesat për shpenzimet fikse ose në burimet financiare të bazuara në rrezik, në varësi të madhësisë dhe të llojit të veprimtarive të kryera nga subjekti i licencuar.*

*4. Autoriteti mund të miratojë me rregullore edhe një format standard për llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit.”*

- Neni 69, pika 3, ku thuhet se:

*“3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore procedurën sipas së cilës ankesat e pazgjithura kundër shoqërisë komisionere mund t’i drejtohen Autoritetit.”*

- Neni 129, ku përcaktohet se:

*“Institucioni i tregut i vendos në dispozicion Autoritetit raporte të tilla si auditimi i administrimit të rrezikut, sipas formës, mënyrës dhe shpeshësisë që mund të përcaktojë me rregullore Autoriteti.”*

- Neni 154, pika 3, ku përcaktohet se:

*“3. Autoriteti mund të përcaktojë me rregullore përmbajtjen dhe strukturën e pasqyrave financiare vjetore të bursës dhe formën e mënyrën e raportimit në Autoritet, përfshirë çdo informacion shtesë, përtej informacionit që kërkohet normalisht për raportet vjetore financiare të shoqërive aksionare.”*

- Neni 197, pika 8, ku përcaktohet se:

*“Autoriteti mund të parashikojë me rregullore detyrime të tjera për shtëpinë e klerimit, siç e konsideron të përshtatshme Autoriteti.”*

- Neni 352, pika 4, që përcakton se:

*“4. Autoriteti mund të përcaktojë më tej me rregullore informacionin që ka gjasa të merret në konsideratë kur merret vendim për bërjen publike të informacionit të privilegjuar.”*

*Të gjitha këto parashikime (por dhe të tjera në përmbajtje të ligjit që nuk janë specifikuar më sipër, si neni 69 pika 4, neni 115 pika 8, neni 121 pika 2, neni 129, neni 172, etj.), nuk plotësojnë kërkesat e nenit 118 paragrafi 2 të Kushtetutës, që përcakton në mënyrë taksative se është ligji ai*

*që duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*

*Ndërkohë që në dispozita të tjera të ligjit, delegimi i të drejtës së autoritetit për të nxjerrë rregullore, është formuluar në mënyrë korrekte, duke specifikuar çështjet që duhet të rregullohen.*

*Gjithashtu, nisur nga natyra e rregullimeve që bëjnë dispozitat e mësipërme dhe që lidhen direkt me mundësinë e aksesit për të ushtruar veprimtaritë që rregullohen nga ky ligj, mospërcaktimi i rasteve konkrete se kur ndërhyt autoriteti me vendimmarrje apo akte nënligjore, cenon lirinë e ushtrimit të aktivitetit ekonomik.*

*Për më tepër, përdorimi i shprehjeve të tilla si “mund të parashikojë”, “mund të përcaktojë”, “mund të rregullojë”, “mund të merret në konsideratë”, “mund t’i kërkojë”, krijojnë terren evaziv legjislativ, dhe zbatimi i ligjit në praktikë do të ngelet në vullnetin e Autoritetit, por jo në detyrimin e tij. Kjo mënyrë e të shkruajturit të ligjit, ul shkallën e përgjegjësisë dhe krijon ambient për zbatim subjektiv dhe preferencial të vetë ligjit.*

**Argumenti 4:** *Veprimet që përfshihen në aktivitetin e klerimit nuk janë të gjitha të renditura qartë në ligj, por delegohen për rregullim me akt të Autoritetit.*

*Përkufizimi i dhënë për termin “Klerim”, në nenin 3, pika 13, kur pasi renditen të gjitha rastet që përbëjnë klerim, shkronja “ç” parashikon se klerimi mund të përfshijë edhe “ç) çdo shërbim tjetër që mund të parashikojë Autoriteti me rregullore”, nuk është në përputhje me nevojën për qartësi të normës juridike.*

*Veprimet që përfshihen në aktivitetin e klerimit, duhet të jenë të renditura qartë në këtë ligj dhe jo të delegohen për rregullim me një akt të Autoritetit. Për më tepër, për klasifikimin e shërbimeve të tjera si klerim nga ky i fundit, ligji nuk ka dhënë asnjë përcaktim, orientim apo qoftë dhe kufizim.*

**Argumenti 5:** *Disa dispozita të ligjit bien ndesh drejtpërdrejt me parashikimet e Kodit Penal dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.*

*Pika 2 e nenit 9 të ligjit përcakton se: “Ushtrimi i veprimtarive të rregulluara në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni konsiderohet vepër penale në kuptim të nenit 170, shkronja “ç”, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.”*

*Neni 356 parashikon se: “Nuk do të përbëjë vepër penale tregtimi bazuar në informacion të privilegjuar kur personi që ka përhapur informacion, që tregton me instrumente financiare ose nxit një person tjetër të tregtojë me instrumente financiare:”.*

*Ndërsa neni 367, parashikon se: “Personi, që ushtron ose pretendon të ushtrojë veprimtari të rregulluara në apo prej territorit të Republikës së Shqipërisë, pa qenë i licencuar, i regjistruar, i njohur apo i përjashtuar, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kryen vepër penale sipas nenit 170 shkronja “ç” të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe dënohet sipas përcaktimeve të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.”*

*Këto parashikime, përveçse bëjnë një referencë të gabuar në numërtimin e dispozitës së Kodit Penal që synojnë t'i referohen (pasi është neni 170/ç dhe jo "neni 170, shkronja 'ç'"), bien ndesh me hierarkinë e akteve të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës.*

*Përcaktimi i veprave penale bëhet vetëm në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Është ky akt ligjor, miratuar me shumicë të cilësuar, që ka përcaktuar se cilat veprime a mosveprime të kryera në cenim të marrëdhënieve të caktuara shoqërore të mbrojtura nga legjislacioni penal, konsiderohen si vepra penale.*

*Ndërsa parashikimi i bërë në nenin 9 të ligjit, paragrafi 2 dhe nenin 367, që përpiqet t'i klasifikojë veprimet e rregulluara nga ligji si konsumim i veprës penale të përcaktuar në nenin 170/ç të Kodit Penal, duke zgjeruar apo ngushtuar kuptimin e zbatimit të tij, cenon hierarkinë e akteve dhe bie ndesh me nenin 116 të Kushtetutës.*

*Neni 1 i Kodit Penal parashikon se është ligji penal ai që përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.*

*Gjykata Kushtetuese ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale.*

*Dispozita, që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81 pika 2 e Kushtetutës.*

*Ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtit të tyre, neni 81, pika 2 e Kushtetutës nuk do të ekzistonte. Legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (shih nenin 1/b të Kodit Penal).*

*Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit nga ana tjetër. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është, gjithashtu, një arsye tjetër që e ka detyruar kushtetutëbërësin të kërkojë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cila, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë.*

**Argumenti 6:** *Ligji nuk përcakton qartë kushtet dhe kriteret për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive në fushën e tregjeve të kapitalit, duke ia lënë kompetencën për përcaktimin e tyre Autoritetit, në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të autorizimit për nxjerrjen e akteve nënligjore sipas nenit 118 të Kushtetutës.*

Ligji nr. 62/2020 nuk përcakton qartë kushtet dhe kriteret për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive në fushën e tregjeve të kapitalit, duke ia lënë kompetencën e përcaktimit Autoritetit, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe mënyrës së autorizimit të nxjerrjes së akteve nënligjore sipas nenit 118 të Kushtetutës.

6.1 Neni 142, përcakton mënyrën se si themelohet bursa. Sipas kësaj dispozite, një ndër kriteret është dhe zotërimi i kapitalit themeltar. Ndërsa pika 3 e këtij neni përcakton se: “Kapitali themeltar i bursës përcaktohet me akt nënligjor.”.

Në kushtet kur kapitali themeltar i bursës paguhet plotësisht në para që në fillim dhe aksionet që përbëjnë kapitalin themeltar nuk mund të emetohen përpara se të jetë paguar vlera e plotë e tyre, kriteri i zotërimit të kapitalit themeltar për themelimin e një burse ka rëndësi thelbësore.

Ky kriter lidhet direkt me mundësinë e themelimit të bursës, ndërsa nga ana tjetër, zotërimi i kësaj shume shërben si garanci për stabilitetin financiar të një shoqërie që vepron në këtë fushë.

Në funksion të mbrojtjes së parimit të sigurisë juridike, ligji duhet të ketë të përcaktuar qartë kufirin minimal monetar apo nivele konkrete orientuese minimale në këtë rast, duke ruajtur të njëjtin standard si për kapitalin minimal fillestar të shoqërive komisionere (neni 17 i ligjit).

Vetëm kështu mund të balancohet nevoja për akses në këtë lloj veprimtarish ekonomike, me kërkesat për qëndrueshmërinë financiare.

6.2 Të njëjtën pengesë shkakton dhe parashikimi i nenit 147, pika 1, që nuk jep asnjë orientim mbi nivelin e tarifës që duhet paguar në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencim të veprimtarisë së bursës. Ligji duhet të përcaktojë nëse në rastin konkret bëhet fjalë për një tarifë që mbulon kostot administrative të shqyrtimit të kërkesës për licencim apo jo.

6.3 Edhe neni 186 i ligjit jep një autorizim të papërcaktuar dhe të pakufizuar, që Autoriteti të miratojë kushte për regjistrimin e personit juridik si operator i njohur i tregut. Ndërsa në nenin 187, sërish nuk përcaktohet se sa duhet të jetë vlera minimale për t`u konsideruar “burim i mjaftueshëm financiar, operativ, teknik dhe njerëzor”, e për t`u pranuar për pasojë kërkesa për regjistrim si operator i njohur i tregut.

Këto dispozita jo vetëm që krijojnë premisa për pengimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, por as nuk përcaktojnë llojin e aktit nënligjor që duhet të dalë për këtë qëllim, duke qenë tërësisht në kundërshtim me parashikimet e nenit 118, paragrafi 2 i Kushtetutës.

**Argumenti 7:** Shitja e pasurisë së lënë si kolateral financiar nga shtëpia e klerimit dhe jo nga Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor bie ndesh me Kodin e Procedurës Civile, duke cenuar nenet 81 pika 2 dhe 116 të Kushtetutës.

*Neni 207 i ligjit parashikon se:*

*“Kur një pasuri është objekt i një marrëveshjeje kolaterali financiar ose është vendosur si kolateral financiar, shitja e kësaj pasurie nga shtëpia e klerimit nuk mund të pengohet nga asnjë proces tjetër ligjor përmbartimi apo urdhër ekzekutimi dhe kjo pasuri nuk mund të përdoret për asnjë shlyerje tjetër nga personi përgjegjës, që kërkon ekzekutimin e interesave apo garancive të vendosura mbi pasurinë, me përjashtim të rastit kur kjo miratohet nga shtëpia e klerimit, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera.”*

*Ndërkohë që titulli i këtij neni është “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, objekt i marrëveshjes së kolateralit financiar”.*

*Përmbajtja e nenit nuk përputhet me titullin e dispozitës. Nëse jemi para rastit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ekzekutimi i tij do të bëhet vetëm në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, sipas rregullave të ekzekutimit të detyrueshëm dhe do të kryhet nga shërbimi përmbartimor gjyqësor.*

*Ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë përcaktohet në nenin 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.*

*Vetë neni 510 i këtij Kodi, përcakton se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Cilat janë aktet që përbëjnë titull ekzekutiv, renditen në mënyrë shteruese në këtë nen të Kodit të Procedurës Civile, që në shkronjën “dh)” të tij ka përcaktuar si titull ekzekutiv edhe kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato, ndërsa në shkronjën “e)”, ka përcaktuar se, titull ekzekutiv janë edhe “aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë”.*

*Nëse pasuria është lënë si kolateral në bazë të një akti që përbën titull ekzekutiv, në momentin që detyrimi i marrë përsipër sipas titulli nuk përmbushet, jemi para rastit të ekzekutimit të detyrueshëm. Norma procedurale civile parashikon vetëm Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm dhe ky veprim (shitja e pasurisë lënë si kolateral) nuk mund të kryhet nga një shtëpi klerimi.*

*Ndaj kjo dispozitë që jo vetëm që nuk përcakton ndonjë akt të ri si titull ekzekutiv (në kuptim të nenit 510, shkronja “e)” të Kodit të Procedurës Civile), por dhe që duket se e bën të ekzekutueshëm titullin konkret direkt, duke përjashtuar zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, si një akt i miratuar me shumicë të cilësuar, cenon direkt nenin 81 pika 2 dhe nenin 116 të Kushtetutës.*

**Argumenti 8:** *Imuniteti nga përgjegjësia penale dhe civile gjatë zbatimit të rregulloreve të shtëpisë së klerimit është në kundërshtim me kushtetutën, cenon rendin juridik dhe parimin e barazisë para ligjit.*

*Neni 210 i ligjit jep imunitet nga përgjegjësia penale dhe civile. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon se:*

*“1. Personat e mëposhtëm nuk mund të jenë objekt i asnjë përgjegjësie penale ose civile:*

*a) personi që përmbush një detyrim në bazë të delegimit sipas rregulloreve të mospërmbushjes së shtëpisë të klerimit në lidhje me ndonjë procedurë mospërmbushjeje; ose*

*b) çdo person që vepron në emër të personit të përmendur në shkronjën “a”, përfshirë:*

*i. çdo anëtar të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të personit të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike; dhe*

*ii. çdo anëtar të çdo komiteti të ngritur nga personi i përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, për çdo veprim (përfshirë deklarata të dhëna) ose mosveprim në mirëbesim gjatë përmbushjes së këtij detyrimi, ose në lidhje me përmbushjen faktike ose të synuar të këtij detyrimi.*

*2. Kur personi përgjegjës vepron në lidhje me pasurinë e një personi, që është në mospërmbushje, në bazë të rregulloreve të mospërmbushjes së shtëpisë së klerimit dhe në mënyrë të arsyeshme beson ose ka baza të arsyeshme për të besuar se ai ka të drejtë ta kryejë këtë veprim, personi përgjegjës nuk mban përgjegjësi për humbjet ose dëmtimet që rezultojnë nga një veprim i tillë, përveçse kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga pakujdesia.”*

*Kategoria e subjekteve që gëzojnë imunitet për raste specifike, është përcaktuar në mënyrë shteruese në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky ligj, i miratuar me shumicë të thjeshtë, nuk mund të parashikojë imunitet nga përgjegjësia civile dhe penale, për veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Aq më pak ta japë këtë imunitet apriori.*

*Imuniteti, si një situatë juridike e privilegjuar për kategori të caktuara subjektësh, nuk mund të aplikohet në këtë rast, duke çuar në mosdënim të plotë. Këto subjekte, që veprojnë veçanërisht në fushën tregjeve të kapitalit, nuk mund të jenë mbi ligjin duke cenuar parimin e barazisë para ligjit.*

*Përmes kësaj dispozite përmbysen rendi juridik në Republikën e Shqipërisë, ku tashmë Kuvendi i Shqipërisë, përmes ligjit tenton që përmes një norme të re të përjashtojë nga përgjegjësia penale individë apo nëpunës të caktuar që do të kryejnë apo realizojnë detyrave brenda sistemit të tregjeve të kapitalit.*

**Argumenti 9:** *Hyrja në mjedise me vendim të gjykatës, në rastet kur është kryer apo po kryhet një veprë penale, bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke imponuar me këtë ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë, mënyrën se si duhet të shprehet gjykata në vendim.*

*Neni 316 i ligjit, që parashikon hyrjen në mjedise me vendim të gjykatës, pavarësisht se mund të vlerësohet si një zgjidhje e shpejtë dhe efektive në rastet kur është kryer apo po kryhet një vepër penale, në çdo rast mbetet një parashikim që bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke imponuar me këtë ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë, mënyrën se si duhet të shprehet gjykata në vendim.*

*Kjo dispozitë duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këto lloj rregullimesh, të parashikuara nga neni 81 pika 2 e Kushtetutës, cenon dhe nenin 116 të Kushtetutës.*

**Argumenti 10:** *Ngrirja e aktiveve të çdo personi me urdhër të Autoritetit është e paqartë për sa i përket rrethit të subjekteve që i drejtohet, ndërkohë që parashikon një masë relativisht të rëndë. Masat administrative duhet të vendosen në raport me dispozitën konkrete që shkelet, duke identifikuar edhe subjektin e shkeljes që penalizohet.*

*Neni 318 i ligjit, pika 2, parashikon se: “Në interes të mbrojtjes së klientëve, Autoriteti mund të japë urdhër për ngrirjen e aktiveve të çdo personi, që bie ndesh me ndonjë dispozitë të këtij ligji, të akteve nënligjore ose urdhrave, për shtatë ditë kalendarike. Autoriteti, me vendim të arsyetuar, mund të zgjasë afatin e urdhrimit për ngrirjen e aktiveve, për të parandaluar shpërndarjen e aktiveve të klientëve, deri në një afat maksimal prej 3 muajsh.”*

*Kjo dispozitë është tepër e paqartë sa i përket rrethit të subjekteve që i drejtohet, ndërkohë që parashikon një masë relativisht të rëndë, deri në ngrirjen e aktiveve. Masat administrative duhet të kenë të përcaktuar qartë nivelin e masës në raport me dispozitën konkrete që shkelet, duke identifikuar kështu edhe subjektin e shkeljes që penalizohet me masë.*

#### **IV. Diskutimi në Komision.**

Përfaqësuesja e institucionit të Presidentit të Republikës paraqiti arsyetimin për kthimin e ligjit, duke dhënë argumentet përkatëse.

Relatori paraqiti opinionin e tij për ligjin nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, duke e vlerësuar atë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe ekonominë e vendit tonë. Kjo është arsyeja për të cilën Kuvendi e ka votuar këtë ligj, të cilin e ka vlerësuar plotësisht në përputhje me Kushtetutën dhe legjisllacionin e brendshëm të vendit tonë. Komisioni për Integrimin Europian ka vlerësuar përputhshmërinë e ligjit me *acquis* të BE-së dhe me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit. Ky ligj është prerogativë e mazhorancës. Ai pritet të sjellë zhvillimin e tregjeve të kapitalit dhe të rrisë efikasitetin e ekonomisë së vendit, ndaj çdo vonesë ndikon negativisht në realizimin e këtij qëllimi. Argumentet për vlerësimin e ligjit janë paraqitur në kohën e miratimit të tij dhe qendrojnë të njëjta edhe aktualisht.



Gjatë diskutimit shumica e anëtarëve të Komisionit paraqitën këto vlerësime për ligjin, dekretin dhe arsyetimet përkatëse:

#### **IV.1. Vlerësime për ligjin nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.**

Ligji nr.62/2020 “Për tregjet e kapitalit” është një ligj mjaft i rëndësishëm dhe i punuar me cilësinë e duhur, për arsye se:

**Së pari**, ligji për tregjet e kapitalit është përgatitur në kuadër të projektit SECO të Qeverisë Zvicerane “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: fokusi në zhvillimin e tregut të kapitaleve”. Ligji u hartua nga ekspertët e Cadogan Financial (një firmë shumë e specializuar, në Mbretërinë e Bashkuar, për zhvillimin dhe rregullimin e tregjeve të kapitalit). Ligji është konsultuar edhe me ekspertë të Bankës Botërore dhe ka pasur mbështetjen e tyre.

Ligji synon të sigurojë përputhshmëri me Direktivat e BE-së: Direktiva e Tregjeve të Instrumenteve Financiare (MiFID II/MIFIR) 2014/65; Direktiva për Transparencën 2004/109; Direktiva mbi abuzimin me tregun 2014/57; Rregullorja e Prospektit 2017/1129; Rregullorja për agjencitë e vlerësimit 462/2013; Rregullorja e Depozitarit Qendror të Titujve 2014/909.

**Së dyti**, hartimi i këtij ligji i përgjigjet nevojave aktuale të tregut të kapitaleve në vendin tonë. Ky treg ka hedhur disa hapa pozitivë, si: rritja dhe zhvillimi i investitorëve institucionalë të rëndësishëm, si fondet e investimeve dhe ato të pensioneve, fillimi i aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve, licencimi i Regjistrisë Shqiptare të Titujve me funksionet e një Depozitari Qendror. Krijimi i këtyre strukturave, si dhe nevoja për zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitaleve dhe rritjen e mbikëqyrjes së tij sollën nevojën për hartimin e ligjit për tregjet e kapitalit.

**Së treti**, ligji për tregjet e kapitalit mundëson realizimin e disa objektivave, që janë:

- Krijimi i një kuadri tërësor rregullator e mbikëqyrës të tregjeve të kapitalit;
- Rritja e potencialit për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, pasi rritet mundësia që emetuesit të gjejnë kapital dhe të financojnë ekonominë, rriten mundësitë për investitorët për fitime më të mira, rriten mundësitë për ndërmjetësit, rritet rentabiliteti i infrastrukturës së tregjeve të kapitalit;
- Nxitja e zhvillimit të tregjeve të kapitalit, si edhe mbrojtja më e mirë e investitorëve.

**Së katërti**, ligji për tregjet e kapitalit është hartuar në përputhje me legjislacionin e brendshëm të vendit tonë, si ligjin nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar; ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin nr.7895, datë 27.1.1992 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar etj.

**Së pesti**, ligji mori kohën e nevojshme gjatë shqyrtimit në Komision dhe u vlerësua i rëndësishëm si nga pala propozuese, ashtu edhe nga anëtarët e Komisionit. Ministria e Financave vuri theksin në rolin që do të luajë ky ligj në sigurimin e alternativave të reja të investimit për biznesin,

akumulimin e kursimeve të qytetarëve, zgjerimin e bazës së investitorit, nxitjen e investitorëve të huaj, si dhe harmonizimin e larmisë së instrumenteve financiare. Anëtarët e Komisionit vlerësuan rolin që do të luajë ky ligj aktualisht në ringritjen e ekonomisë, pas dy goditjeve që ajo pësoi: tërmetit të fundvitit të mëparshëm dhe pandemisë shëndetësore të COVID-19. Ata vlerësuan, në mënyrë të veçantë, risitë që sjell ligji në drejtim të mbrojtjes së investitorëve, licencimit dhe rregullimit të institucioneve të tregut të kapitaleve, mirëfunksionimit të tregut dhe forcimit të mbikëqyrjes së tij.

***Së gjashti***, gjatë shqyrtimit të projektligjit për tregjet e kapitalit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat dëgjoi edhe mendimin e grupeve të interesit, si më poshtë:

- Shoqata Shqiptare e Bankave;
- Shoqëria “Bursa ALSE”, sha;
- Shoqëria “Alreg”, sha;
- Shoqëria “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a;
- Shoqata e Tregtimit të Titujve.

Përfaqësuesit e grupeve të interesit e vlerësuan projektligjin mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e tregut të kapitaleve, kreditimin e biznesit dhe zhvillimin e ekonomisë. Komisioni përfshiu në ligj një pjesë të rëndësishme të propozimeve të grupeve të interesit.

Komisioni mori edhe mendimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe përfshiu në ligj amendamentet e propozuara prej tij, për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar.

## **IV.2. Vlerësime mbi argumentet e paraqitura për kthimin për rishqyrtim të ligjit.**

Lidhur me argumentet për kthimin për rishqyrtim të ligjit, të paraqitura në arsyetimin e dekretit, Komisioni paraqet mendimet si më poshtë:

***Së pari, lidhur me argumentin që në vendin tonë nuk janë përmbushur parakushtet për një zhvillim të suksesshëm të tregjeve të kapitalit, Komisioni është i mendimit se:***

### **Për pikat 1 dhe 1.1:**

Ekzistenca e tregut të kapitalit është një mundësi shumë e mirë për ekonominë e një vendi. Mungesa e ligjit, jo vetëm pengon zhvillimin e këtij tregu, por krijon mundësi për abuzime. Për këtë arsye, miratimi i këtij ligji në përputhje me të gjitha direktivat dhe rregulloret e përmendura më lart, ka për qëllim që të nxisë zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe ta drejtojë atë drejt standardeve më të larta të BE-së.

Lidhur me argumentin e dekretit se “Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e tij të nëntorit 2017, tërheq vëmendjen se zhvillimi i tregut të kapitalit duhet të udhëhiqet nga standardet e BE-së dhe se zhvillimi i tij do të marrë kohë dhe është një proces i ndërlikuar”, Komisioni u shpreh dakord me këtë raport. Komisioni është i ndërgjegjshëm se zhvillimi i tregut të kapitalit është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar. Përgatitja dhe miratimi i ligjit është hapi i parë i domosdoshëm i këtij procesi.

### **Për pikat 1.2 dhe 1.3 (treguesit makroekonomikë):**

Forcimi i treguesve makroekonomikë është një ndër objektivat e reformës për Menaxhimin e Financave Publike. Realizimi i këtyre treguesve ndiqet në vijimësi nga Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe mbikëqyret nga Kuvendi. Niveli i ulët i inflacionit, politikat e kujdeshme monetare, përpjekja për uljen e vazhdueshme të nivelit të borxhit do të jenë në fokusin e këtyre institucioneve edhe në të ardhmen.

Zhvillimi i tregut të kapitalit ka një rol të dyfishtë, nga njera anë si matës i ecurisë dhe besueshmërisë së ekonomisë dhe nga ana tjetër si faktor ndikues në zhvillimin ekonomik.

- Lidhur me shqetësimin që në vendet anëtare të BE-së “mungesa e qeverisjes së fortë të korporatave minoi zhvillimin financiar, duke kërkuar standarde më relaksuese të listimit të korporatave”, Komisioni është i mendimit se direktiva MFID2 u hartua nga BE për të adresuar shqetësimet e mëparshme dhe se ky ligj përputhet pjesërisht me këtë direktivë, e cila është e vitit 2014.

- Lidhur me shqetësimin që në vendet anëtare të BE-së “likuiditeti i kufizuar ka qenë një pengesë e rëndësishme për investitorët dhe zhvillimin e tregut”, Komisioni është i mendimit se neni 318 i ligjit parashikon kompetencat e Autoritetit për të marrë masa ndaj personave që kanë kryer shkelje ligjore, në mbrojtje të investitorëve, siç janë urdhrat për zbatimin e rregullores, vendosja e gjobave, dhënia e vërejtjes, korrigjimi i shkeljes, përfshirë shpërblimin e dëmit ndaj personave të dëmtuar, deri në ngrirjen e aktiveve. Gjithashtu, ligji i jep Autoritetit kompetenca për të mbrojtur aktivet e investitorëve, si: mund të urdhërojë shoqërinë komisionere të mos tregtojë më paratë ose aktivet e investitorëve, mund t’i ndalojë shoqërisë komisionere kryerjen e transaksioneve, kërkimin e shërbimeve nga të tretët, t’i kërkojë shoqërisë komisionere të ushtrojë veprimtarinë tregtare në mënyrën që mund të përcaktojë Autoriteti; ose të mbajë pasuri në territorin e Republikës së Shqipërisë në një vendndodhje që e përcakton Autoriteti.

Gjithashtu, në ligj janë përcaktuar qartë detyrimet e kompanive të listuara për transparencën e informacionit dhe standardin e raportimeve. Në tërësinë e tij, ky ligj përshkohet nga kujdesi për mbrojtjen e investitorëve.

Shqipëria është një vend që ka një raport të ulët kredi/depozita. Në kushtet kur depozituesit, të vetmet mundësi investimi kanë depozitat bankare, kemi biznese që kanë nevojë për likuiditete dhe investitorë që nuk kanë opsione investimi. Depozitat bankare janë instrument i sigurt, por me kthim investimi shumë të ulët. Ky është edhe një nga faktorët që spjegon se shumë para qarkullon jashtë sistemit bankar.

- Lidhur me shqetësimin se në vendet anëtare të BE-së “standardet e papërshtatshme të raportimit, mungesa e vlerësimeve të *rating*-ut të besueshëm të korporatave dhe strukturave të pronësisë ndikuan në zbatimin e dobët të ligjit në praktikë”, Komisioni është i mendimit se:

Shqipëria, ndër vite, ka ndërmarrë nisma ligjore për përmirësimin e standardeve financiare të raportimit dhe për monitorimin e tyre. Baza ligjore për hartimin e pasqyrave financiare është ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Ky ligj përcakton detyrimin ligjor të zbatimit të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në hartimin e pasqyrave financiare, në bazë të klasifikimit të njësive ekonomike.

Ligji nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, parashikon dispozitat që rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, të shoqërive të auditimit, të kontabilistit të miratuar, si dhe rregullimin e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit.

Nëpërmjet këtij ligji është ngritur institucioni i Bordit të Mbikqyrjes Publike, si një mekanizëm për mbikëqyrjen e profesionit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese me qëllim rritjen e sigurisë, që auditimet ligjore të pasqyrave financiare të kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik.

#### **Për pikën 1.4:**

Lidhur me pretendimin e dekretit se disa tregues të ekonomisë sonë janë të dobët dhe pengojnë zhvillimin e tregut të kapitaleve (sipas dekretit, tregues të tillë janë: niveli i lartë i borxhit publik, ekonomia informale, madhësia e vogël e ndërmarrjeve me sisteme të dobëta të qeverisjes korporative, mungesa e një liste të qartë të kompanive që veprojnë në vend, të sistemeve të dobëta të kontrollit të bilanceve të çertifikuar, institucione të dobëta qeverisëse ligjore, rregullatore dhe korporative për të mbrojtur investitorët, niveli i lartë i kredive të këqija, si dhe mungesa e një vlerësimi të korporatave shqiptare nga kompani të vlerësuara ndërkombëtarisht), Komisioni është i mendimit se:

Në raportin “Doing Business 2020” Shqipëria renditet e 111-ta, për shkak të mungesës së një burse funksionale. Sipas indikatorëve të këtij raporti, konsiderohet që mungesa e bursës bën që aksionerët në minorancë t’i nënshtrohen aksionerëve që mbajnë shumicën e aksioneve, pasi ata nuk kanë lirshmërinë që t’i tregtojnë aksionet e tyre në një bursë të rregulluar. Në mënyrë që Shqipëria të përmirësojë renditjen e saj në këtë indikator, miratimi i ligjit nuk është i mjaftueshëm, por është i domosdoshëm drejt krijimit të kushteve reale të tregtimit të aksioneve të çdo aksioneri, por veçanërisht të atyre në minorancë.

Lidhur me pretendimin që “mungon një vlerësim i korporatave shqiptare nga kompani të vlerësuara ndërkombëtarisht”, Komisioni është i mendimit se nenet 239 dhe 240 i dedikohen agjensive të huaja të vlerësimit të rrezikut të kreditit. Sipas këtyre neneve, çdo person juridik, i licencuar ose i njohur si Agjenci e Huaj e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit, mund të njihet nga

Autoriteti nëse plotëson disa kushte, që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve, bashkëpunimin e tij me Autoritetin, si dhe bashkëpunimin midis Autoritetit dhe personave përgjegjës për mbikëqyrjen e subjektit në vendin ku ndodhet selia e tij qendrore. Gjithashtu, Autoriteti njeh të gjitha Agjencitë e Vlerësimit të Rrezikut të Kreditit që janë licencuar, regjistruar apo njohur nga Autoriteti Europian i Tregjeve të Titujve. Çdo Agjenci e huaj e njohur e vlerësimit të rrezikut të kreditit raporton të paktën një herë në vit për ngjarjet që kanë ndodhur dhe ndikimin e tyre në vlerësimin e Autoritetit ose në konkurrencën në treg.

*Së dyti, lidhur me argumentet e paraqitura në pikat 2 dhe 2.1 - 2.7 të arsytimit të dekretit, se ligji i jep AMF-së të drejta të pakufizuara në fushën e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të veprimtarive që janë objekt i tij, duke rrezikuar të cenojë parimin e sigurisë juridike, lirinë e veprimtarisë ekonomike nga subjektet e licencuara dhe barazinë para ligjit, Komisioni është i mendimit se:*

A) Kompetencat e AMF-së, të parashikuara në ligjin 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, janë në linjë me kompetencat e parashikuara në Direktivën MIFID II të BE-së (Direktiva 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 maj 2014, "Për tregjet e instrumenteve financiare, që ndryshon direktivën 2002/92/KE dhe direktivën 2011/61/BE").

Në nenin 69 të kësaj direktive theksohet se autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse, siç janë: të kenë akses në dokumente ose të dhëna të rëndësishme, të **kërkojnë informacion nga cilido person**, të kryejnë kontrole ose hetime në terren; të **kërkojnë marrjen e masave që janë në kundërshtim me direktivën apo me rregulloren**, të **kërkojnë pezullimin e tregtimit të instrumentit financiar etj.**

B) Kompetencat e AMF-së, të parashikuara në ligjin 62/2020 “Për tregjet e Kapitalit”, janë në linjë me kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar. Këto kompetenca lidhen me:

- Rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura;
- Miratimin e rregullave, rregulloreve, vendimeve dhe udhëzimeve;
- Kërkesën e shpjegimeve me shkrim, të dokumentacionit; të verifikimeve në palë të treta etj.

Pra, kompetencat që i janë dhënë AMF-së në ligjin 62/2020 “Për tregjet e Kapitalit” janë në të njëjtën linjë me direktivat e BE-së dhe me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar. Për këtë arsye, pretendimi i dekretit për këtë çështje nuk qendron.

*Së treti, lidhur me pretendimin se në shumë dispozita të ligjit nuk është bërë delegim i mirëfilltë i kompetencave të Autoritetit, por është lënë në mënyrë opsionale mundësia e tij për të rregulluar me akt nënligjor çështje të caktuara, duke përdorur shprehjet “mund të miratojë” “mund të*

***përcaktojë”, “mund të kërkojë“ etj, në arsyetimin e dekretit theksohet se këto dispozita janë në kundërshtim me nenin 118 pika 2 të Kushtetutës dhe lirinë e ushtrimit të aktivitetit ekonomik.***

***Së katërti, lidhur me pretendimin se veprimet që përfshihen në aktivitetin e klerimit nuk janë të gjitha të renditura qartë në ligj, por delegohen për rregullim me akt të Autoritetit.***

**Për pikat 3 dhe 4 Komisioni është i mendimit se:**

Autoriteti e realizon funksionin rregullator nëpërmjet nxjerrjes së rregulloreve, e përcaktuar kjo në ligjin nr.9572/2006 “Për AMF-në” dhe ligjin 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Në respektim të parimit të hierarkisë së akteve, ku nxjerrja e rregulloreve, akteve nënligjore, duhet të autorizohet nga dispozita përkatëse e ligjit, në mbi 60 dispozita të ligjit 62/2020 është parashikuar një gjë e tillë. Por, nisur nga specifika e tregjeve të kapitalit që janë tregje në zhvillim, me një dinamikë e shpejtësi që kërkon të njëjtën shpejtësi reagimi nga rregullatori, është pikërisht kjo specifikë, arsyeja që edhe pse në momentin e miratimit të ligjit mund të mos jetë i nevojshëm një akt nënligjor, përcaktimi në ligj i mundësisë së nxjerrjes së një rregulloreje i jep Autoritetit, autorizimin dhe aktin nënligjor, bazën ligjore për nxjerrjen e tij. Qëllimi është arritja e objektivit, pra tregje të sigurta, transparente, mbrojtje e investitorit, konsumatorit.

Për analogji me ligjin për tregjet e kapitalit, është ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ku në edhe në këtë ligj në shumë nene të tij është përcaktuar detyrimi për nxjerrjen e rregulloreve si edhe në nene të tjera është përcaktuar mundësia e daljes së rregulloreve në përmbushje të funksionit rregullativ që ka Autoriteti.

***Së pesti, lidhur me pretendimin se disa dispozita të ligjit bien ndesh me Kodin Penal dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të vendit tonë, Komisioni është i mendimit se:***

Ligji penal njih parashikimin e veprave penale edhe nga ligje të tjera. Sipas nenit 1/a të Kodit Penal, “legjislacioni penal përbëhet nga ky Kod dhe nga ligje të tjera, që parashikojnë vepra penale”. Në nenet 9 dhe 367 të ligjit për tregjet e kapitalit nuk është bërë përshkrimi i veprës penale dhe as është caktuar masa e dënimit, por vetëm citohet që veprimi në kundërshtim me këto dispozita ligjore, duke qenë pa licencë, i paregjistruar apo i panjohur dënohet sipas parashikimeve të Kodit Penal.

***Së gjashti, lidhur me pretendimin se ligji nr. 62/2020 nuk përcakton qartë kushtet dhe kriteret për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive në fushën e tregjeve të kapitalit, duke ia lënë kompetencën e përcaktimit Autoritetit, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe mënyrës së autorizimit të nxjerrjes së akteve nënligjore sipas nenit 118 të Kushtetutës, Komisioni është i mendimit se qendrojnë argumentet e cituara më lart.***

Në pikat 6.1-6.3 ngrihet këto pretendime.

*Pika 6.1. Përcaktimi i kapitalit themeltar të Bursës me akt nënligjor, pa përcaktuar kufij orientues minimalë në ligj, prek parimin e sigurisë juridike dhe cenon qëndrueshmërinë e saj.*

*Pika 6.2. Parashikimi i nenit 147, pika 1, nuk jep asnjë orientim mbi nivelin e tarifës që duhet paguar në momentin e paraqitjes së kërkesës për licencim të veprimtarisë së bursës. Ligji duhet të përcaktojë nëse në rastin konkret, bëhet fjalë për një tarifë që mbulon kostot administrative të shqyrtimit të kërkesës për licencim apo jo.*

*Pika 6.3. Edhe neni 186 i ligjit jep një autorizim të papërcaktuar dhe të pakufizuar, që Autoriteti të miratojë kushte për regjistrimin e personit juridik si operator i njohur i tregut. Ndërsa në nenin 187, sërish nuk përcaktohet se sa duhet të jetë vlera minimale për t'u konsideruar "burim i mjaftueshëm financiar, operativ, teknik dhe njerëzor", e për t'u pranuar për pasojë kërkesa për regjistrim si operator i njohur i tregut. Këto dispozita jo vetëm që krijojnë premisa për pengimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, por as nuk përcaktojnë llojin e aktit nënligjor që duhet të dalë për këtë qëllim, duke qenë tërësisht në kundërshtim me parashikimet e nenit 118, paragrafi 2 i Kushtetutës.*

**Për pikën 6.1 dhe pikën 6.3** Komisioni është i mendimit se:

Aktualisht Direktiva MIFID II, tek e cila është bazuar ligji nr. 62/2020 "Për tregjet e kapitalit", nuk parashikon kërkesa për kapitalin minimal të Bursës.

Edhe Direktiva CRD IV (Capital Requirements Directive), e cila parashikon kërkesa për kapitalin dhe fondet e veta për shoqëritë komisionere dhe bankat, nuk parashikon një kërkesë të tillë për operatorin e tregut apo bursën.

Praktika rregullatore e përcaktimit të kapitalit në rregullore është një praktikë e cila lidhet ngushtë me zhvillimin dhe dinamikën e tregut, duke i lejuar fleksibilitet Autoritetit Rregullator për ta ndryshuar kërkesën për kapital minimal në një linjë me dinamikën, madhësinë dhe zhvillimin e tregut të kapitaleve.

Sqarojmë se ky parim është përdorur edhe në ligje të tjera të fushës financiare, si ligji nr.55/2020 "Për shërbimet e pagesave".

**Për pikën 6.2** Komisioni është i mendimit se:

Të gjitha tarifat e licencimeve në AMF caktohen me rregullore të miratuar nga Bordi i AMF-së, në zbatim të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar. Autoriteti mbledh nga subjektet e mbikëqyrura tarifa për aplikim, dhënie e rinovime licencash, miratimesh dhe autorizimesh, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të legjislationit në fuqi apo **rregulloreve** të Autoritetit.

***Së shtati, lidhur me pretendimin se shitja e pasurisë së lënë si kolateral financiar nga shtëpia e klerimit dhe jo nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor bie ndesh me Kodin e Procedurës Civile, duke cenuar nenet 81 pika 2 dhe 116 të Kushtetutës, Komisioni është i mendimit se:***

Kjo dispozitë është në harmoni me Kodin Civil, me Kodin e Procedurës Civile dhe me ligjin e posaçëm që rregullon marrëveshjet e kolateralit financiar.

Në Kodin e Procedurës Civile në nenin 510, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Konsiderohen tituj ekzekutivë, sipas shkronjës “dh”, kambialet, çeqet e **letrat me urdhër që barazohen** me to.

Në Kodin Civil, në nenin 546, thuhet se dispozitat për pengun nuk zbatohen në rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

Në ligjin nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, në nenin 2 pika 2 përcaktohet se në mënyrë të veçantë, dispozitat e kreut IV të ligjit rregullojnë të gjitha rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar. Sipas neni 24 të këtij ligji, në fushën e zbatimit të tij përfshihen marrëveshjet e kolateralit financiar të lidhura ndërmjet personave juridikë, ku të paktën, njëra nga palët është Republika e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë, një bankë qendrore e huaj, një bankë, një institucion financiar, një institucion i huaj i ngjashëm me bankat dhe institucionet financiare, një agjent shlyerës, një operator ose një autoritet publik vendas apo ndërkombëtar. Marrëveshja e kolateralit financiar mund të sigurojë të gjitha llojet e detyrimeve financiare, përfshirë ato të tanishme ose të ardhme, ato aktuale ose të kushtëzuara apo të mundshme, që dhënësi i kolateralit apo cilido person tjetër i detyrohet marrësit të kolateralit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

***Së teti, në lidhje me pretendimin se imuniteti nga përgjegjësia penale dhe civile, gjatë zbatimit të rregulloreve të shtëpisë së klerimit, është në kundërshtim me kushtetutën, cenon rendin juridik dhe parimin e barazisë para ligjit, Komisioni është i mendimit se:***

Shtëpia e Klerimit është një institucion që zbaton urdhërat e transmetuara nga subjektet të cilët janë anëtarë të shtëpisë së klerimit dhe duhet të realizojë finalitetin e shlyerjes në çdo rast duke eliminuar mospërmbushjet. Shtëpia e klerimit nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet apo urdhërat e dhëna nga palë të treta. Kjo është një praktike ndërkombëtare.

***Së nënti, lidhur me pretendimin se hyrja në mjedise me vendim të gjykatës, në rastet kur është kryer apo po kryhet një vepër penale, bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke imponuar me këtë ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë, mënyrën se si duhet të shprehet gjykata në vendim, Komisioni është i mendimit se:***

Direktiva MIFID II, e BE-së (Direktiva 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 maj 2014 "Për tregjet e instrumenteve financiare, që ndryshon direktivën 2002/92/KE dhe direktivën 2011/61/BE"), në pikën 143, përcakton se: është e nevojshme që autoritetet kompetente, në përputhje me të drejtën e brendshme dhe me Kartën, të kenë aftësinë e aksesit në ambientet e personave fizikë ose juridikë. Aksesit në këto ambiente është i nevojshëm në rastin kur ka dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e dokumenteve dhe të dhënave të tjera, që lidhen me çështjen në



fjalë të investigimit si të rëndësishme për të provuar një shkelje të kësaj direktive ose të Rregullores (BE) nr. 600/2014. Përveç kësaj, **aksesi në këto ambiente** është i nevojshëm në rastin kur personi, të cilit i është kërkuar informacioni, nuk arrin të veprojë në përputhje me këtë kërkesë, plotësisht ose pjesërisht; ose në rastin kur ka baza të arsyeshme për të besuar mospërputhjen e kërkesës së mundshme, ose heqjen, abuzimin apo shkatërrimin e informacionit në lidhje me kërkesën për informacion. Nëse, në përputhje me të drejtën e brendshme, kërkohet autorizimi paraprak i autoritetit gjyqësor për shtetin anëtar përkatës, kjo kompetencë e aksesit të ambienteve duhet të përdoret pas marrjes paraprake të autorizimit gjyqësor.

Direktiva MIFID II, gjithashtu në nenin 69, kompetencat mbikëqyrëse, parashikon se:

“1. Autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse, duke përfshirë kompetencat hetuese dhe kompetencat e caktimit të rikuperimeve të nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014.

2. Kompetencat e përmendura në paragrafin 1 përfshijnë të paktën kompetencat si më poshtë:

a) akses në çdo dokument ose të dhënë të çdo forme tjetër, të konsideruar si të rëndësishme nga autoriteti kompetent, në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, duke marrë, nëse kërkohet ose jepet, kopjen të tij;

b) të kërkojnë informacion nga cilido person, nëse është e nevojshme, të thërrasin persona dhe t'i marrin në pyetje për qëllime të marrjes së informacioneve;

c) **për të kryer kontrole ose hetime në terren;....”.**

Në ligjin kuadër të funksionimit të AMF-së nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, në nenin 19 parashikohet se : Për ushtrimin e inspektimit, subjekti i mbikëqyrur është i detyruar t’u ofrojë dokumentacion ose çdo të dhënë tjetër, të shkruar, mjetet e nevojshme për inspektim, nëse i kërkohet kjo, si dhe t’u përgjigjet pyetjeve në mjediset e Autoritetit; personat e kontaktit, nga radhët e të punësuarve, për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit; **hyrje pa limit në mjediset** e zyrave; të gjitha llogaritë, dokumentacionin tregtar dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, për të përcaktuar faktet dhe rrethanat, në lidhje me çështjet për të cilat kryhet inspektimi; pas një kërkesë paraprake, fotokopjet e llogarive dhe të dokumenteve të tjera, ku të shënohet me shkronja shtypi “E njëjtë me origjinalin”, si dhe data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar nga personi i inspektuar.

*Së dhjeti, në lidhje me pretendimin se ngrirja e aktiveve të çdo personi, me urdhër të Autoritetit, është e paqartë për sa i përket rrethit të subjekteve që i drejtohet, ndërkohë që parashikon një masë relativisht të rëndë dhe se masat administrative duhet të vendosen në raport me dispozitën konkrete që shkelet, duke identifikuar edhe subjektin e shkeljes që penalizohet, Komisioni është i mendimit se:*

Direktiva MIFID II e BE-së (Direktiva 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 maj 2014, "Për tregjet e instrumenteve financiare", që ndryshon direktivën 2002/92/KE dhe direktivën 2011/61/BE"), në nenin 69 “Kompetencat mbikëqyrëse” parashikon se:

1. Autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse, duke përfshirë kompetencat hetuese dhe kompetencat e caktimit të rikuperimeve të nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive dhe sipas Rregullores (BE) nr. 600/2014.

2. Kompetencat e përmendura në paragrafin 1 përfshijnë të paktën kompetencat si më poshtë:

a) akses në çdo dokument ose të dhënë të çdo forme tjetër, të konsideruar si të rëndësishme nga autoriteti kompetent, në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, duke marrë, nëse kërkohet ose jepet, kopjen të tij;

b) të kërkojnë informacion nga cilido person, nëse është e nevojshme, të thërrasin persona dhe t'i marrin në pyetje për qëllime të marrjes së informacioneve;

c) për të kryer kontrolle ose hetime në terren;

d) të kërkojnë regjistrimet ekzistuese të bisedave telefonike ose komunikimet elektronike ose regjistrime të tjera të qarkullimit të të dhënave në zotërim nga shoqëritë e investimit, institucioni kreditor ose çdo subjekt tjetër që rregullohet nga kjo **direktivë ose nga Rregullorja (BE) nr. 600/2014;**

**e) të kërkojnë bllokimin ose sekuestrimin e aktiveve, ose të dyja bashkë.**

Në ligjin kuadër të funksionimit të AMF-së nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, në nenin 18 përcaktohet se me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, **bankat** janë të detyruara që, për subjektet e mbikëqyrura, t'i japin Autoritetit të dhëna për numrat dhe kodet e llogarive ekzistuese apo të mbyllura, si dhe datën e transaksionit të fundit të kryer. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet, që përbëjnë shkelje të këtij ligji, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre emrin e personit, që është marrë me hartimin e tyre, u dorëzohen palëve të treta nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vetëm me miratimin paraprak të personit në fjalë, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.

Pra, Komisioni është i mendimit se pretendimi i dekretit edhe për këtë çështje nuk qendron, pasi ligji është i përputhur me direktivën e BE-së.

## **V. Përfundim.**

Në përfundim, duke analizuar dhe argumentuar se ligji nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, direktivat e BE-së dhe legjislacionin e brendshëm dhe se ky ligj përbën një mekanizëm të suksesshëm për zgjerimin dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit në vendin tonë, Komisioni e rrëzoi dekretin nr.11510, datë 15.6.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit” me shumicë votash.

**RELATORI**  
**Ervin BUSHATI**

**KRYETARJA**  
**Milva EKONOMI**